

Indeksi i Fizibilitetit të Programit Qeverisës “Rama 4”

Monitorimi dhe vlerësimi i
përmbushjes së Programit
Qeverisës 2025-2029 për 100
ditët e para dhe vitin 2025

**Nga premtimi politik te
llogaridhënia**



INDEKSI I FIZIBILITETIT TË PROGRAMIT QEVERISËS “RAMA 4”

Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së Programit Qeverisës
2025–2029 për 100 ditët e para dhe vitin 2025

Raporti i parë monitorues

FEASIBILITY INDEX OF THE GOVERNMENT PROGRAM “RAMA 4”

Monitoring and evaluation of the fulfillment of the Government
Program 2025–2029 for the first 100 days and the year 2025

First monitoring report

JEL Codes: D63, D78, E61, E62, F35, H11, H50, H75, I18, I28, J24, O19, O38, P16, R58

Fjalëkyçe / Keywords

Fjalëkyçe: barazi, drejtësi, pabarazi, politika fiskale, integrim në BE, digjitalizim, shëndetësi publike, politika arsimore, infrastruktura, mirëqenie sociale

Keywords: equity, justice, inequality, fiscal policy, EU integration, digitalization, public health, education policy, infrastructure, social welfare

Polifakt – Paper/Report Nr. 101/2025

27 Dhjetor 2025

Rreth Polifakt

Polifakt është një platformë e pavarur vlerësimi dhe monitorimi e krijuar për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare në politikë dhe qeverisje në Shqipëri.

Ajo fokusohet në matjen e besueshmërisë së premtimeve politike dhe performancës së qeverisë përmes analizave të detajuara, raporteve dhe treguesve të matshëm si **Indeksi i Fizibilitetit të Programit (IFP)**.

Polifakt synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të argumentuar mbi **ndikimin ekonomik, social dhe institucional të politikave publike**, duke mbështetur qytetarët, ekspertët dhe institucionet në vendimmarrje të informuar. Përmes vlerësimit të premtimeve dhe performancës së politikave, Polifakt rrit **llogaridhënien e zyrtarëve publikë** dhe **besimin e publikut** në proceset demokratike.

Ky model monitorimi ndihmon në identifikimin e rreziqeve sistemike, pa u ndalur vetëm te rezultatet, por duke analizuar edhe **kapacitetet institucionale, disiplinën fiskale, koherencën dhe realizueshmërinë në kohë të objektivave**.

About Polifakt

Polifakt is an independent evaluation and monitoring platform designed to enhance transparency, accountability, and civic engagement in politics and governance in Albania.

It focuses on **measuring the credibility of political promises** and the **government's performance** through detailed analyses, reports, and measurable indicators such as the **Index of Feasibility & Performance (IFP)**.

Polifakt aims to provide clear, evidence-based insights into the **economic, social, and institutional impact** of public policies, supporting citizens, experts, and decision-makers with reliable information. By evaluating promises and policy implementation, Polifakt strengthens **accountability of public officials** and **public trust** in democratic processes.

The platform goes beyond reporting outcomes by assessing **institutional capacities, fiscal discipline, policy coherence, and time-bound feasibility** of objectives, helping identify systemic risks that could undermine good governance.

Kushtet e përdorimit

Ky dokument është i mbrojtur nga ligji për të drejtat e autorit dhe vihet në dispozicion **vetëm për përdorim kërkimor, arsimor dhe jo-komercial**, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

1. **Përdorimi i lejuar**
Materiali mund të përdoret për qëllime akademike, kërkimore ose profesionale, me kusht që burimi të citohet në mënyrë të plotë dhe të saktë (ALTAX, 2025).
2. **Ndalimi i përdorimit komercial**
Çdo formë përdorimi komercial, përfshirë shitjen, shpërndarjen me qëllim fitimi ose modifikimin e përmbajtjes, është e ndaluar pa autorizim paraprak me shkrim nga ALTAX.
3. **Atribuími i detyrueshëm**
Në çdo riprodhim, citim ose referencë ndaj materialit, duhet të përmenden qartë autori, titulli i dokumentit dhe burimi origjinal.
4. **Opinione dhe përgjegjësi**
Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të ALTAX-it apo të partnerëve të tij. ALTAX nuk mban përgjegjësi për përdorimin e pasaktë, keqinterpretimin ose aplikimin e gabuar të materialit.
5. **Riprodhimi dhe shpërndarja**
Riprodhimi dhe shpërndarja lejohen vetëm për qëllime jo-komerciale, me kusht që përmbajtja të ruhet e pandryshuar dhe atribuími të bëhet në mënyrë të rregullt.

Për autorizime shtesë ose sqarime, ju lutemi kontaktoni: info@altax.al

© *Të gjitha të drejtat e rezervuara*

Terms of Use

This document is protected by copyright law and is made available **exclusively for research, educational, and non-commercial use**, subject to the following conditions:

1. **Permitted use**
The material may be used for academic, research, or professional purposes, provided that the source is fully and accurately cited (ALTAX, 2025).
2. **Commercial restrictions**
Any commercial use, including sale, profit-oriented distribution, or modification of the content, is strictly prohibited without prior written authorization from ALTAX.
3. **Mandatory attribution**
Any reproduction, quotation, or reference must clearly indicate the author, the title of the document, and the original source.
4. **Opinions and liability**
The views and interpretations expressed in this document are those of the authors and do not necessarily reflect the official positions of ALTAX or its partners. ALTAX assumes no responsibility for misuse, misinterpretation, or improper application of the material.
5. **Reproduction and distribution**
Reproduction and distribution are permitted solely for non-commercial purposes, provided that the integrity of the content is preserved and proper attribution is maintained.

For additional authorizations or clarifications, please contact: info@altax.al

© *All rights reserved*

Falënderime

Ky raport monitorimi dhe vlerësimi i programit qeverisës është rezultat i një procesi të strukturuar, rigoroz dhe të pavarur analitik, i realizuar nga ekipi kërkimor i ALTAX-it në bashkëpunim me kontribues të jashtëm dhe me mbështetjen metodologjike të platformës **Polifakt**, si instrument i dedikuar për ndjekjen, verifikimin dhe vlerësimin e angazhimeve qeveritare.

Falënderime të veçanta u drejtohen:

- ✓ **Autorëve kryesorë**, për konceptimin e kornizës së monitorimit dhe vlerësimit, ndërtimin e indikatorëve të performancës, analizën ekonometrike dhe interpretimin e rezultateve në funksion të zbatueshmërisë së programit qeverisës.
- ✓ **Ekipit të Polifakt**, për mbledhjen, verifikimin dhe strukturimin e të dhënave mbi premtimet dhe masat e programit, si dhe për kontributin në ndërtimin e matricave të monitorimit dhe alarmit të rrezikut.
- ✓ **Përpunuesve të të dhënave statistikore**, për saktësinë metodologjike, harmonizimin e burimeve zyrtare dhe ndërkombëtare, si dhe vizualizimin e rezultateve analitike.
- ✓ **Ekspertëve vullnetarë**, për komentet profesionale, etike dhe kritike, të cilat kanë ndihmuar në forcimin e objektivitetit, koherencës dhe besueshmërisë së vlerësimit.
- ✓ **Dizajnerit grafik**, për formatimin profesional të raportit dhe përkthimin vizual të gjetjeve analitike në forma të qarta dhe të lexueshme për publikun dhe vendimmarrësit.
- ✓ **Koordinatorës ekzekutive**, për drejtimin e procesit të monitorimit, koordinimin ndërinstitucional dhe integrimin e vizionit strategjik të ALTAX-it në këtë vlerësim gjithëpërfshirës.

Ky raport pasqyron angazhimin e ALTAX-it dhe Polifakt për **monitorim të bazuar në evidencë, transparencë publike dhe vlerësim të pavarur të performancës qeverisëse**, në funksion të rritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të cilësisë së politikëbërjes.

Për komente, sqarime ose mundësi bashkëpunimi të mëtejshme në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave publike, ju lutemi kontaktoni: info@altax.al

Lidhu me ALTAX-Polifakt / Connect with ALTAX-Polifakt

Qëndroni të informuar me analizat, kërkimet dhe zhvillimet më të fundit në fushën e politikave ekonomike dhe fiskale. ALTAX ofron një ekosistem burimesh të besueshme për studiues, vendimmarrës dhe aktorë publikë.

Stay informed with the latest analysis, research, and developments in the field of economic and fiscal policies. ALTAX provides an ecosystem of trusted resources for researchers, decision-makers, and public stakeholders.

Burimet Kryesore

ALTAX – www.altax.al

Platforma qendrore e analizave, raporteve dhe studimeve mbi ekonominë dhe financat publike.

Central platform for analyses, reports and studies on the economy and public finances.

Polifakt – www.polifakt.al

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të premtimeve politike, bazuar në të dhëna dhe metodologji të verifikuara.

System for monitoring and evaluating political promises, based on verified data and methodologies.

YouTube – [ALTAX Channel](#)

Video analitike, materiale edukative dhe diskutime mbi temat kyçe të politikave publike.

Analytical videos, educational materials, and discussions on key public policy topics.

Aplikacioni ALTAX

I disponueshëm në *App Store* dhe *Google Play*, me përditësime të menjëhershme, njoftime dhe akses të shpejtë në raportet tona.

Available on the App Store and Google Play, with instant updates, notifications and quick access to our reports.

Rrjetet Sociale

Ndiqui ALTAX në [Facebook](#), [LinkedIn](#), [Twitter/X](#) dhe [Instagram](#) për njoftime, infografika dhe komunikime të shpejta.

Follow ALTAX on social media for quick announcements, infographics, and communications.

Përmes kërkimit rigoroz dhe të paanshëm, ne synojmë të ndërtojmë një hapësirë publike më transparente dhe një të ardhme ekonomike më të qëndrueshme.

Through rigorous and impartial research, we aim to build a more transparent public space and a more sustainable economic future.

Kontakt / Contact

Web: www.altax.al

Email: info@altax.al

HYRJE

Programet qeverisëse nuk janë thjesht dokumente administrative apo lista dëshirash politike. Ato përfaqësojnë **kontratën themelore midis qeverisë dhe qytetarëve**.

Në një demokraci funksionale, këto programe mishërojnë angazhime konkrete që duhet të përktihen në politika publike të matshme, në alokime buxhetore reale dhe në fund të fundit, në rezultate të prekshme dhe të verifikueshme për jetën e përditshme të njerëzve.

Programi Qeverisë 2025–2029, i miratuar pas zgjedhjeve të majit 2025, paraqitet si një platformë tejat ambicioze për transformimin e vendit.

I strukturuar mbi **tre shtylla kryesore**

(i) **Shqipëria europiane dhe shteti modern**, me fokus integrimin në BE, digjitalizimin dhe luftën kundër korrupsionit; (ii) **Rritja ekonomike e qëndrueshme**, që synon stabilitet fiskal, investime të huaja, infrastrukturë dhe inovacion; (iii) **Mirëqenia për të gjithë**, me premtime të mëdha në arsim, shëndetësi, politika sociale dhe strehim,

ky program premtion një hop cilësor në zhvillimin e vendit deri në vitin 2029, me synimin final të anëtarësimit në Bashkimin Europian deri në 2030.

Megjithatë, përmasat e këtij programi, si në numrin e objektivave, ashtu edhe në kostot fiskale të pritshme e bëjnë **monitorimin e pavarur një domosdoshmëri publike, jo thjesht një opsion**.

Në një kohë kur sfidat ekonomike, sociale dhe institucionale mbeten të mëdha, qytetarët kanë të drejtë të dinë jo vetëm çfarë premtiohet, por edhe **nëse këto premtime janë realisht të zbatueshme, të financuara dhe të matshme**.

Në këtë kontekst, **Polifakt**, si organizatë e pavarur fakt-verifikuese dhe monitoruese e politikave publike merr përsipër rolin e një vëzhguesi të pavarur, objektiv dhe analitik. Qëllimi ynë është të ndjekim në kohë reale procesin e kthimit të premtimeve politike në politika konkrete: të verifikojmë nëse angazhimet hyjnë në buxhete, nëse zbatohen sipas afateve të deklaruara, dhe nëse rezultatet finale përputhen me atë që u është premtuar qytetarëve.

Ky raport i parë, që mbulon **100 ditët e para të mandatit (18 shtator – 26 dhjetor 2025)** – shënon fillimin e një monitorimi sistematik dhe të vazhdueshëm, me publikime periodike çdo 6 muaj.

Duke u bazuar në Indeksin e Fizibilitetit të Programit (IFP), ne synojmë të ofrojmë një pasqyrë të qartë, të dhëna të verifikuara dhe sinjale të hershme për qytetarët, median dhe vetë institucionet, për të kontribuar në një qeverisje më transparente dhe më llogaridhënëse.

Nga premtimi politik te llogaridhënia publike – ky është misioni ynë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

INDEKSI I FIZIBILITETIT TË PROGRAMIT QEVERISËS 2025–2029 (IFP)

Monitorimi 100 Ditor (18 Shtator – 26 Dhjetor 2025)

Në 100 ditët e para të mandatit të katërt qeverisës, Programi Qeverisës 2025–2029 ka treguar një fillim të përzier: avancime të dukshme në disa prioritet strategjike, por edhe pengesa serioze që ulin fizibilitetin e përgjithshëm. **Indeksi i Fizibilitetit të Programit (IFP) arrin në 72 pikë nga 100 pikë të mundshme**, duke e vendosur në kategorinë “fizibilitet mesatar–i mirë” (60–79 pikë). Kjo do të thotë se programi është i zbatueshëm në parim, por kërkon korrigjime urgjente për të shmangur rreziqe afatmesme dhe afatgjata.

Vlerësimi sipas shtyllave kryesore:

Shtylla I – Shqipëria Europiane & Shteti Modern (IFP: 75 pikë) tregon progres të fortë në integrimin europian (hapja e të gjitha kapitujve të negociatave brenda 2025 është rekord historik), por ulje e ndjeshme nga skandalet e korrupsionit në institucione kyçe si AKSHI dhe administratë.

Shtylla II – Rritja Ekonomike e Qëndrueshme (IFP: 71 pikë) tregon performancë të mirë në turizëm (rekord absolut 11.7 milionë vizitorë) dhe investime të huaja, por vonesa të mëdha në infrastrukturë dhe rrezik fiskal nga informaliteti dhe Paqja Fiskale.

Shtylla III – Mirëqenie për të Gjithë (IFP: 69 pikë) tregon fillime pozitive në arsim (laboratorë SMART +650) dhe rritje pagash, por sfida në shëndetësi dhe politika sociale për shkak të zbatimit të ngadaltë dhe financimit të kufizuar.

Niveli i përgjithshëm i përmbushjes

Nga 65 objektivat operacionalë (përmbledhje e 420 pikave të programit), rreth 20% janë në linjë të plotë (■), 70% në proces me sfida (■) dhe 10% në rrezik të lartë (■). Periudha ka qenë kryesisht përgatitore (formim qeverie, buxhet 2026) por shumica e pikave të programit përfaqësojnë vijimësi të drejtpërdrejtë të politikave dhe projekteve të nisura gjatë mandatit të mëparshëm (Rama 3)

Ritmi i zbatimit është i pabarabartë, pasi konstatohet i shpejtë në fusha si BE dhe turizëm, por i ngadalshëm në reforma institucionale dhe projekte infrastrukture.

Arsyet kryesore të vlerësimit mesatar

Pikat pozitive (driverët e IFP-së) janë hapja e plotë e negociatave me BE-në, rekord turizmi, rritje pagash reale (+11.6%), stabilitet fiskal fillestar (deficit 2.3%) dhe fillime në digjitalizim (Diella, GovTech).

Rreziqet kryesore (pengesat) janë akuzat e korrupsionit (akuza në AKSHI për “grup kriminal” dhe në infrastrukturë për abuzime tenderash me vlerë dhjetëra milionë euro), të cilat ulin besueshmërinë institucionale. Po ashtu edhe vonesa në projekte të mëdha (p.sh. Porto Romano, operator mbetjesh etj.), si dhe performancë e ulët në uljen e informalitetit.

Programi ka potencial të lartë, por fizibiliteti mesatar tregon nevojë për veprime korrigjuese urgjente me auditime të pavarura për skandalet e korrupsionit, përshejtim të PPP-ve transparente dhe forcim të mekanizmave të llogaridhënies. Pa këto, rreziqet mund të rriten në 2026.

Më poshtë është përmbledhja e Indeksit të fizibilitetit për 3 shtyllat e programit (IFP):

SHTYLLA I – QEVERISJA, DIGJITALIZIMI, DREJTËSIA

Vlerësim mesatar = 75 (i lartë, por i pabarabartë)

1–6 Integrimi European → 89 (shumë i lartë)

- **Fiskal (23)**. Kostot janë kryesisht administrative dhe të mbuluara nga IPA.
- **Institucional (22)**. Strukturat negociuese ekzistojnë dhe janë aktive.
- **Kohor (21)**. Objektivat janë procedurale (hapje, raporte, koordinim).
- **Koherencë (23)**. Plotësisht në linjë me axhendën BE.

Ky është segmenti **më i fizibël i programit**, sepse bazohet në procese tashmë të nisura dhe vullnet politik të konsoliduar. Rreziku kryesor nuk është dështimi, por **mbivlerësimi i progresit real**.

7–13 Digjitalizim & Administratë → 65 (kufi kritik)

- **Fiskal (17)**. Kosto operative të menaxhueshme, por jo të vogla.
- **Institucional (16)**. Kapacitete të centralizuara, por me probleme integriteti.
- **Kohor (15)**. Problemet teknike nuk zgjidhen shpejt.
- **Koherencë (17)**. Digjitalizim pa reformë organizative të plotë.

Kjo zonë është **funksionale, por e brishtë**. Skandalet (AKSHI), ndërveprueshmëria e kufizuar dhe mungesa e besimit publik e ulin fizibilitetin real, pavarësisht retorikës së fortë.

14–18 Drejtësi & Siguri → 71 (i qëndrueshëm)

- **Fiskal (18)**. Shpenzime të vazhdueshme, jo shtesë të mëdha.
- **Institucional (18)**. SPAK & ICMJ funksionalë.
- **Kohor (17)**. Ndryshimet janë inkrementale.
- **Koherencë (18)**. Reformë tashmë e konsoliduar.

Sektor **relativisht i stabilizuar**, por me rrezik reputacional. Progresi matet më shumë me *mos-regres* sesa me transformim.

◆ SHTYLLA I – VLERËSIM FINAL = 75

👉 Shtyllë politikisht e fortë, teknikisht e pabarabartë

👉 Integrimi “tërheq” mesataren lart, digjitalizimi e “tërheq” poshtë

SHTYLLA II – EKONOMIA, FISKALITETI, INFRASTRUKTURA

Vlerësim mesatar = 71 (i mirë, por me rrezik fiskal latent)

19–24 Politika Fiskale → 73

- Disiplinë buxhetore ekziston
- Rreziku vjen nga iniciativa ad-hoc (Paqe Fiskale)

📌 **Fizibilitet i mirë**, por shumë i ndjeshëm ndaj vendimeve politike të paplanifikuara.

25–30 Biznes & Tregje → 72

- Klima ligjore është e qëndrueshme
- Reformat janë më shumë procedurale sesa strukturore

📌 **Zbatueshmëri mesatare e lartë**, pa efekt transformues afatshkurtër.

31–39 Infrastruktura → 64 (zona më problematike)

- **Fiskal (16)**: Kosto të larta kapitale
- **Kohor (15)**: Projektet nuk mbyllen në 100 ditë
- **Koherencë (16)**: PPP-të rrisin riskun fiskal

📌 **Interpretim kritik:**

Kjo është **zona me rrezikun më të madh operacional dhe reputacional**, sidomos për shkak të vonesave dhe akuzave për korrupsion.

40–45 Punësim & Treg Pune → 75

- Politika ekzistuese, jo eksperimente
- Treguesit janë të qëndrueshëm

📌 **Segment i balancuar**, me rezultate të matshme.

📌 SHTYLLA II – VLERËSIM FINAL = 71

👉 Ekonomikisht e qëndrueshme

👉 Infrastruktura = pika e dobët strukturore

SHTYLLA III – KAPITALI NJERËZOR & MBROJTJA SOCIALE

Vlerësim mesatar: 69 (i moderuar)

46–52 Arsimi → 67

- Investime të dukshme (lab, kampuse)
- Reformat strukture kërkojnë kohë

53–58 Shëndetësia → 69

- Digjitalizim pilot
- Burime njerëzore nën presion

59–65 Politika Sociale → 72

- Skemat ekzistuese zgjerohen lehtësisht
- Efekti është stabilizues, jo transformues

Kjo shtyllë është në aspektin **social e nevojshme**, por **reformimi i saj është i ngadaltë** në afatin 100-ditor dhe vitin 2025.

VLERËSIMI TOTAL I PROGRAMIT → 72 / 100

ÇFARË DO TË THOTË 72?

- Program i **realizueshëm**, jo maksimalist
- I fortë në **proces & stabilitet**
- I dobët në **transformim strukturor të shpejtë**

RREZIQET KRYESORE TRANSVERSALE

1. Infrastrukturë + PPP → risk fiskal
2. Digjitalizim pa integritet institucional
3. Politika fiskale ad-hoc
4. Over-reporting progresi në integrim

QËLLIMI I MONITORIMIT NGA POLIFAKT

Polifakt e monitoron Programin Qeverisës 2025–2029 me katër qëllime themelore:

1. Llogaridhënie publike

Do të verifikohet nëse angazhimet e shpallura:

- janë përfshirë në dokumentet zyrtare të buxhetit,
- janë shndërruar në politika konkrete,
- po zbatohen sipas afateve të deklaruara.

2. Matje e realizueshmërisë

Do të vlerësohet nëse objektivat:

- janë financiarisht të përballueshme,
- janë institucionalisht të zbatueshme,
- përputhen me kapacitetet reale të administratës publike.

3. Transparencë dhe informim i qytetarëve

Do të përkthehet gjuha politike dhe teknike në:

- analiza të kuptueshme,
- tregues të qartë,
- sinjale të hershme për rreziqe ose devijime nga programi.

4. Përmirësim i politikave publike

Monitorimi nuk synon vetëm evidentimin e mangësive, por:

- ofrimin e alternativave,
- krahasimin me praktikat e BE-së,
- sugjerimin e korrigjimeve në kohë reale.

QËLLIMI SPECIFIK I MONITORIMIT TË PROGRAMIT QEVERISËS 2025–2029

Monitorimi i Programit Qeverisës 2025–2029 nga Polifakt nuk kufizohet në verifikimin formal të realizimit të premtimeve, por synon të vlerësojë cilësinë, realizueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e politikave publike që burojnë prej tij.

Qëllimi konkret i këtij monitorimi është trefish:

1. Vlerësimi i fizibilitetit real të programit

Do të analizohet nëse angazhimet:

- janë të përputhshme me kapacitetet fiskale të vendit,
- mbështeten nga korniza ligjore dhe institucionale ekzistuese,
- kanë probabilitet real zbatimi brenda afateve të shpallura.

Ky dimension synon të dallojë midis premtimeve politike të dëshirueshme dhe politikave publike të realizueshme.

2. Monitorimi dinamik i zbatimit, jo vetëm rezultatit final

Ndryshe nga vlerësimet retrospektive, Polifakt monitoron:

- ritmin e zbatimit,
- devijimet nga plani fillestar,
- ndryshimet e prioriteteve buxhetore,
- përshtatjen (ose mospërshtatjen) e politikave me realitetin ekonomik.

Kjo qasje lejon identifikimin e hershëm të vonësive strukturore, rreziqeve fiskale dhe mospërputhjeve midis diskursit politik dhe veprimit administrativ.

3. Krijimi i një instrumenti të krahasueshëm publik

Monitorimi synon të prodhojë një instrument standard, të përsëritshëm dhe të krahasueshëm në kohë, që:

- u shërben qytetarëve për informim,
- institucioneve për vetëkorrigjim,
- medias për analizë faktike,
- studiuesve për vlerësime afatgjata të qeverisjes.

Ky instrument është **Indeksi i Fizibilitetit të Programit (IFP)**.

METODOLOGJIA E INDEKSIT TË FIZIBILITETIT TË PROGRAMIT

Indeksi i Fizibilitetit të Programit (IFP) është një tregues sintetik i ndërtuar nga Polifakt për të matur në mënyrë objektive dhe të përsëritshme realizueshmërinë reale të Programit Qeverisës 2025–2029. Ai nuk vlerëson vlerën politike ose ideologjike të premtimeve, por vetëm nëse ato janë të mundshme, të mbështetura dhe të qëndrueshme në praktikë.

1. Baza analitike janë 65 objektiva operacionale

Programi origjinal (420 pika) është shndërruar në **65 objektiva operacionale** të qarta, të matshme dhe të grupuara sipas tre shtyllave. Këto objektiva janë **statikë** (*ndryshojnë vetëm në rast rishikimi metodologjik të programit*) dhe shërbejnë si njësia bazë e vlerësimit.

2. Katër komponentët e IFP-së (me peshë ndikimi nga 25% secili)

Çdo objektiv operacional vlerësohet individualisht në katër dimensione, me pikë nga 0 deri në 25 për secilin:

1. Fizibiliteti fiskal (25%)

- Përputhja me Buxhetin Afatmesëm dhe dokumentet zyrtare fiskale.
- Ndikimi në deficitin buxhetor, borxhin publik dhe rregullat fiskale.
- Ekzistenca dhe besueshmëria e burimeve të financimit (të ardhura tatimore, fonde BE, PPP, etj.).

2. Fizibiliteti institucional (25%)

- Kapacitetet e administratës publike për zbatim (struktura, staf, trajnim).
- Qartësia e ndarjes së përgjegjësisë ndërinstytucionale.
- Ekzistenca e akteve nënligjore, rregulloreve dhe mekanizmave zbatues.

3. Fizibiliteti kohor (25%)

1. Realizimi i objektivave të ndërmjetëm (milestones).
2. Respektimi i afateve të deklaruara ose të nënkuptuara.
3. Shkalla e vonesave sistematike ose rreziqet e shtyrjes së afateve.

4. Koherenca strategjike dhe europiane (25%)

- Përputhja me *acquis communautaire* dhe standardet e BE-së.
- Konsistenca e brendshme mes sektorëve (shmangia e kontradiktave).
- Harmonizimi me strategjitë kombëtare ekzistuese dhe prioritetet europiane.

3. Logaritja e indeksit

Niveli individual. Çdo objektiv operacional merr një pikë totale 0–100 (shuma e 4 komponentëve).

Niveli i shtyllës. Mesatarja e thjeshtë e objektivave brenda secilës shtyllë.

IFP total. Mesatarja e ponderuar e tre shtyllave (ose mesatarja e thjeshtë e 65 objektivave).

4. Shkalla e interpretimit

Pikë	Interpretimi	Përshkrim
0–39	Fizibilitet i ulët	Rrezik i lartë moszbatimi
40–59	Fizibilitet i kufizuar	Nevojë urgjente për korrigjim
60–79	Fizibilitet mesatar–i mirë	Zbatim i mundshëm me kushte
80–100	Fizibilitet i lartë	Program i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm

5. Periodiciteti dhe burimet

Frekuenca. IFP llogaritet dhe publikohet **çdo 6 muaj** (qershor dhe dhjetor).

Burimet:

- Dokumente zyrtare (buxhete, raporte qeveritare, ligje, strategji).
- Të dhëna statistikore (INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave).
- Raporte ndërkombëtare (Komisioni European, FMN, Banka Botërore, SIGMA/OECD).
- Verifikim faktik i pavarur nga Polifakt.

6. Transparenca dhe përditësimi

Të gjitha vlerësimet janë të hapura dhe të dokumentuara (me burime).

Çdo 6 muaj publikohet:

- IFP total dhe sipas shtyllave,
- Matrica e statusit të 65 objektivave,
- Alarme rreziku për objektivat kritikë.

Metodologjia është publike dhe mund të rishikohet vetëm në rast ndryshimi të strukturës së programit qeverisës.

Kjo metodologji siguron që IFP të jetë një instrument objektiv, krahasues në kohë dhe i dobishëm për qytetarët, institucionet dhe median, një urë reale midis premtimit politik dhe rezultatit të matshëm.

SHËNIM PËR TRANSPARENCËN DHE PUBLIKUN

Para se të kalojmë te vlerësimi i detajuar i 65 objektivave operacionalë dhe llogaritja e IFP-së për periudhën 18 shtator – 26 dhjetor 2025, është e rëndësishme të sqarojmë disa parime themelore të këtij monitorimi, për të garantuar transparencë të plotë ndaj publikut:

1. **Pavarësia editoriale.** Polifakt është një iniciativë e pavarur fakt-verifikuese. Vlerësimet bazohen vetëm në të dhëna zyrtare, raporte ndërkombëtare dhe fakte të verifikuara – pa ndikim politik apo institucional.
2. **Burimet dhe verifikimi.** Çdo vlerësim shoqërohet me burime publike (qeveri.al, INSTAT, Komisioni European, FMN, etj.). Ku ka paqartësi ose mungesë të dhënash zyrtare, kjo evidentohet qartë.
3. **Qasja konstruktive.** Qëllimi nuk është kritika për kritikën, por identifikimi i hershëm i rreziqeve dhe sugjerimi i alternativave (krahasuar me praktikën më të mira të BE-së ose vendeve të ngjashme).
4. **Hapja ndaj korrigjimeve.** Nëse qeveria ose palë të interesuara ofrojnë të dhëna të reja ose korrigjime faktike, Polifakt angazhohet të përditësojë raportin në edicionin pasues.
5. **Open data.** Të gjitha matricat, llogaritjet dhe të dhënat burimore do të jenë të disponueshme në format open (Excel/Google Sheets) në faqen polifakt.al për verifikim të pavarur nga çdokush.

Ky monitorim shërben për qytetarët për të kuptuar se ku po shkojnë taksat e tyre dhe sa reale janë premtimet e bëra në emër të tyre.

STRUKTURË ANALITIKE E PROGRAMIT

SHTYLLA I – Shqipëria europiane dhe shteti modern. Kjo shtyllë përqendrohet në integrimin në BE, shtetin digjital, administratën pa letra, drejtësinë, sigurinë dhe politikën e jashtme.

Ambicie shumë e lartë, por me varësi të fortë nga faktorë të jashtëm (BE) dhe nga kapacitetet reale institucionale brenda vendit.

SHTYLLA II – Rritja ekonomike e qëndrueshme. Fokusi është te financat publike dhe politika fiskale, biznesi dhe investimet, inovacioni, infrastruktura, energjia, bujqësia dhe turizmi.

Programi synon rritje ekonomike dhe zgjerim të bazës prodhuese, por kërkon balancë të kujdesshme mes stimulit fiskal, konsolidimit buxhetor dhe rrezikut të rritjes së borxhit publik.

SHTYLLA III – Mirëqenie për të gjithë. Përfshin arsimin dhe formimin profesional, shëndetësinë, politikën sociale, familjen dhe strehimin.

Premtime të forta sociale, por që kërkojnë financim afatgjatë, menaxhim efikas dhe matje të qarta të ndikimit social.

Monitorimi i Programit Qeverisës 2025–2029 nga Polifakt është një ushtrim demokratik, teknik dhe qytetar. Ai synon të sigurojë që vizioni politik të mos mbetet deklarativ, ambicia të shoqërohet me përgjegjësi dhe qytetarët të kenë informacion të saktë dhe të pavarur.

Në një mandat të karakterizuar nga premtime të mëdha dhe transformime të shpejta, monitorimi nuk është opozitë politike, por garanci institucionale për cilësinë e qeverisjes

PËRMBAJTJA

Seksioni	Nën-seksioni	Përmbajtja kryesore	Qëllimi / Përdorimi
Prezantimi i Programit Qeverisës	Përshkrim i përgjithshëm	Monitorimi i objektivave 2025–2029 (18 Shtator – 26 Dhjetor 2025)	Të japë kontekst për lexuesin mbi periudhën dhe qëllimin e monitorimit
1. Objektivat Operacionalë	Matrica e objektivave	ID, Shtylla, Nën-shtylla, Objektivi operacional, Përshkrim i shkurtër	Referencë për secilin objektiv dhe lidhjen me shtyllat strategjike
2. Vlerësimi 100-ditor	Statusi i realizimit	KPI, Burimi, 100-ditori, Realizimi, Status, Koment analitik	Tregon progresin fillestar dhe rreziqet e identifikuara në 100 ditët e para
2.1. Sqarime për secilin objektiv	Detaje objektiv	Analizë e avancimit, sfidave, barrierave dhe rezultateve për secilin objektiv	Jep një kuptim më të thellë për të kuptuar arsyet e statusit
3. Vlerësimi i Fizibilitetit (IFP)	Indeksi i Fizibilitetit	Dimensione: Fiskal, Institucional, Kohor, Koherencë, TOTAL	Vlerëson zbatueshmërinë reale të objektivave në 100 ditë dhe identifikon riskun
3.1. Analiza e Shtyllave Strategjike	Shtylla I, II, III	Integrimi & Qeverisja, Ekonomia & Infrastrukturë, Kapitali Njerëzor & Sociale	Jep vlerësim të përgjithshëm për secilën shtyllë dhe përmbledh progresin, sfidat dhe rreziqet
4. Alarmet e Rrezikut	Matrica e Alarmeve	ID objektivi, Status, Arsye rreziku, Veprim i rekomanduar	Identifikon pikat kritike dhe veprimet prioritare për të mbrojtur zbatimin e programit
5. Konkluzione & Mesazhe kryesore	Përmbledhje	Vlerësim total i programit, pikat e forta dhe të dobëta, rekomandime për qeverisjen	Siguron lexuesit me kuptimin final të progresit, rreziqeve dhe domosdoshmërisë për veprim

PËRMBUSHJA E PROGRAMIT QEVERISËS 2025 – 2029

100 ditët e para dhe viti 2025

1. OBJEKTIVAT OPERACIONALË

ID	Shtylla	Nën-shtylla	Objektivi operacional	Përshkrim i shkurtër
1	I	Integrimi & qeverisja	Progresi i kapitujve të negociatave	Hapja dhe mbyllja e kapitujve BE (Statik)
2	I	Integrimi & qeverisja	Harmonizimi ligjor me acquis	Përafrimi i legjisllacionit me standardet BE (Statik)
3	I	Integrimi & qeverisja	Kapaciteti negociues institucional	Struktura dhe trajnimi për negociata (Statik)
4	I	Integrimi & qeverisja	Transparenca e procesit të integritit	Informim publik dhe raportim (Statik)
5	I	Integrimi & qeverisja	Përafrimi i politikave sektoriale	Harmonizim sektorial me acquis (Statik)
6	I	Integrimi & qeverisja	Koordinimi ndërinstitutional BE	Mekanizma koordinimi (Statik)
7	I	Shteti digjital & administrata	Digjitalizimi i shërbimeve publike	e-Albania 2.0 dhe shërbime online (Statik)
8	I	Shteti digjital & administrata	Përdorimi real i platformave	Kalimi nga ekzistencë në përdorim aktiv (Statik)
9	I	Shteti digjital & administrata	Siguria kibernetike	Strategji dhe kapacitete kibernetike (Statik)
10	I	Shteti digjital & administrata	Ndërveprueshmëria e databazave	Interoperabilitet i sistemeve (Statik)
11	I	Shteti digjital & administrata	Reforma e burimeve njerëzore	Rekrutim meritokratik dhe trajnim (Statik)
12	I	Shteti digjital & administrata	Depolitizimi i administratës	Garanci profesionale (Statik)
13	I	Shteti digjital & administrata	Sistemet e integritetit & antikorrupsionit	Mekanizma parandalimi korrupsioni (Statik)
14	I	Drejtësia & siguria	Efikasiteti i sistemit të drejtësisë	Ulje stok çështjesh dhe kohëzgjatje (Statik)
15	I	Drejtësia & siguria	Zbatimi i reformës në drejtësi	Vetting dhe funksionalitet institucione (Statik)
16	I	Drejtësia & siguria	Siguria publike	Smart City dhe reagim policor (Statik)

ID	Shtylla	Nën-shtylla	Objektivi operacional	Përshkrim i shkurtër
17 I		Drejtësia & siguria	Menaxhimi i emergjencave	Kapacitete civile dhe 112 (Statik)
18 I		Drejtësia & siguria	Politika e jashtme & diaspora	Partneritete dhe IHD (Statik)
19 II		Financa publike & fiskale	Stabiliteti fiskal	Deficit dhe rregulla fiskale (Statik)
20 II		Financa publike & fiskale	Borxhi publik	Ulje graduale borxhi/PBB (Statik)
21 II		Financa publike & fiskale	Cilësia e shpenzimeve publike	Efikasitet dhe prioritet (Statik)
22 II		Financa publike & fiskale	Administrimi tatimor	Transparencë dhe evazion ↓ (Statik)
23 II		Financa publike & fiskale	Formalizimi i ekonomisë	Luftë informalitet (Statik)
24 II		Financa publike & fiskale	Parashikueshmëria fiskale	Paqe fiskale dhe planifikim (Statik)
25 II		Biznesi & investimet	Klima e biznesit	Lehtësim barrash (Statik)
26 II		Biznesi & investimet	Barrat administrative	Ulje procedurash (Statik)
27 II		Biznesi & investimet	Investimet e huaja	Mobilizim kredi dhe IHD (Statik)
28 II		Biznesi & investimet	Ndërmarrjet e vogla & inovacioni	Mbështetje NMV dhe startup (Statik)
29 II		Biznesi & investimet	PPP & risku fiskal	Partneritete publike-private (Statik)
30 II		Biznesi & investimet	Konkurrenca & tregjet	Mbrojtje konsumatori (Statik)
31 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Infrastruktura rrugore	700 km të reja (Statik)
32 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Transporti publik	Hekurudha dhe MobAl (Statik)
33 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Uji & mbetjet	Furnizim 24h dhe menaxhim mbetje (Statik)
34 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Energjia & diversifikimi	1500 MW rinovues (Statik)
35 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Tranzicioni i gjelbër	Ekonomi qarkulluese (Statik)
36 II		Infrastruktura & sektorët kyç	Bujqësia & zinxhiri i vlerës	Eksporte 1 mld € (Statik)

ID	Shtylla	Nën-shtylla	Objektivi operacional	Përshkrim i shkurtër
37 II	Infrastruktura & sektorët kyç		Zhvillimi rural	Ujitje dhe ferma moderne (Statik)
38 II	Infrastruktura & sektorët kyç		Turizmi i qëndrueshëm	Netëqëndrime x2 (Statik)
39 II	Infrastruktura & sektorët kyç		Dixhitalizimi ekonomik	Cashless Albania (Statik)
40 II	Tregu i punës		Punësimi	Papunësi 6% (Statik)
41 II	Tregu i punës		Pagat & produktiviteti	Pagë mesatare 1000€ (Statik)
42 II	Tregu i punës		Formimi profesional	35% nxënës profesional (Statik)
43 II	Tregu i punës		Migracioni ekonomik	Marrëveshje bilaterale (Statik)
44 II	Tregu i punës		Barazia gjinore në punë	Ulje hendek pagash (Statik)
45 II	Tregu i punës		Siguria në punë	Standarde pune (Statik)
46 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Arsimi parauniversitar	200 shkolla të reja (Statik)
47 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Arsimi profesional	Konvikte dhe laboratorë (Statik)
48 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Arsimi i lartë	Kampuse dhe ndërkombëtarizim (Statik)
49 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Lidhja arsim-treg pune	Model dual (Statik)
50 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Digjitalizimi i arsimit	1000 laboratorë inteligjentë (Statik)
51 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Cilësia e mësimdhënies	Pagë mësues 1250€ (Statik)
52 III	Arsimi & kapitali njerëzor		Barazia në akses	Transport falas dhe after school (Statik)
53 III	Shëndetësia		Financimi i shëndetësisë	Autonomi spitalore (Statik)
54 III	Shëndetësia		Akses & cilësi shërbimi	Kontroll bazë falas (Statik)
55 III	Shëndetësia		Burimet njerëzore	+25% pagash mjekë (Statik)
56 III	Shëndetësia		Digjitalizimi shëndetësor	Dosje elektronike (Statik)
57 III	Shëndetësia		Barnat & furnizimi	Akses universal (Statik)
58 III	Shëndetësia		Parandalimi & shëndeti publik	Mekanizma krizash (Statik)

ID	Shtylla	Nën-shtylla	Objektivi operacional	Përshkrim i shkurtër
59 III		Politikat sociale & strehimi	Skemat e mbrojtjes sociale	Rritje shpenzime sociale (Statik)
60 III		Politikat sociale & strehimi	Pensionet	400€ mesatar (Statik)
61 III		Politikat sociale & strehimi	Mbështetja familjare	Paketë familje e re (Statik)
62 III		Politikat sociale & strehimi	Strehimi social	1500 njësi (Statik)
63 III		Politikat sociale & strehimi	Varfëria & përjashtimi	Ulje varfërie (Statik)
64 III		Politikat sociale & strehimi	Personat me aftësi ndryshe	Dyfishim pagesa PAK (Statik)
65 III		Politikat sociale & strehimi	Politikat për të rinjtë	Garanci Rinore 40k (Statik)

2. VLERËSIMI SIPAS MONITORIMI 100 DITOR I PROGRAMIT QEVERISËS 2025–2029

(18 Shtator – 26 Dhjetor 2025)

Statusi: ☐ Jo nisur | ☐ Në proces | ☐ Në linjë | ☐ Në rrezik

Ky raport pasqyron progresin fillestar, me avancime të dukshme në integrim europian dhe turizëm, por sfida serioze në luftën kundër korrupsionit dhe infrastrukturë. Vlerësimi është më pak konservator, duke reflektuar ritmin e shpejtë të disa reformave (si BE dhe digjital fillestar), por duke evidentuar rreze të larta nga akuzat e reja të korrupsionit.

ID	KPI	Burimi	100-ditori	Realizimi	Status	Koment analitik
1	Kapituj hapur	KE / Kryeministria.al	Hapje të plotë	Të gjitha 33 kapitujt hapur (Cluster 5: 17/11/2025)	☒	Rekord historik, progres drejt mbylljes 2027
2	Ligje harmonizuara	Kuvendi	Draftet fillestare	Draftet në proces për Cluster 5	☐	Ritëm i ngadalhtë
3	Trajnime negociatorë	MAPBE	Struktura e re	Struktura aktive	☐	Kapacitete në rritje
4	Raporte transparence	MAPBE	Publikim periodik	Raporte mujore	☐	Përmirësim i kufizuar
5	Politika sektoriale	Sektorët	Avancim	Progres në energji & drejtësi	☐	Harmonizim mesatar
6	Koordinim	Këshilli Ministrave	Takime të rregullta	Aktiv	☒	Funksional
7	% shërbime online	AKSHI	95%+	95%; Diella lançuar	☐	Probleme funksionimi & akuza korrupsioni
8	Përdorues aktivë	e-Albania	Rritje	Rritje me ankesa	☐	Përdorim i ngadalshëm
9	Strategji kibernetike	AKCESK	Miratim	Miratuar 2025-2030	☒	Implementim nisur
10	Databaza të ndërlidhur	AKSHI	Progres	GovTech në vijim	☐	Ndërveprueshmëri e kufizuar
11	Rekrutime transparente	ASPA	Portal aktiv	100% portal	☐	Përmirësim mesatar
12	Indeks depolitizim	SIGMA	Monitorim	Pa ndryshim të madh	☐	Stabil, por pa përparim
13	Raste korrupsion	SPAK	Strategji e re	SPAK aktiv, kreu i ri; akuza në AKSHI & infrastrukturë	☒	Skandale të reja (AKSHI grup kriminal, Balluku tendera) ulin besueshmërinë
14	Kohëzgjatje çështjesh	ICMIS	Nisje ICMJ	ICMJ operacional	☐	Vonesa në stok

ID	KPI	Burimi	100-ditori	Realizimi	Status	Koment analitik
15	Vetting & SPAK	KL Gj	Konsolidim	Vetting përfunduar	■	Reformë konsoliduar
16	Reagim policor	Policia	Kontratë Smart City	Nisur në 20 qytete	■	Progres i kufizuar
17	Kapacitete emergjence	Emergjencia Civile	Zgjerim	Qendra të reja	■	Në proces
18	IHD & partneritete	FM	Rekord	~1.7 mld €	■	Rritje, por ndikuar nga klimë politike
19	Deficit/PBB	MF	~2.3%	2.3%	■	Në linjë
20	Borxh/PBB	MF	Stabil	~55-56%	■	Ulje e ngadaltë
21	Efikasitet shpenzime	MF	Përmirësim	Buxhet performancë	■	Prioritete të kufizuara
22	Evazion tatimor	DPT	Progres	Digjitalizim	■	Luftë mesatare
23	Informalitet	INSTAT	Ulje	Vazhdueshme	■	Pa ulje drastike
24	Paqe fiskale	MF	Diskutim	Në proces	■	Rrezik nga FMN
25	Doing Business	ËB	Përmirësim	Liberalizim	■	Klimë mesatare
26	Kohë procedurash	AIDA	Ulje	Lehtësim	■	Progres i kufizuar
27	IHD	Banka Shqiptare	Rekord	Rekord 2025	■	Rritje
28	Startup & NMV	AIDA	Evente	Nisur	■	Inovacion mesatar
29	PPP të reja	ATRAKO	Aktiv	Monitorim	■	Risk i lartë
30	Mbrojtje konsumatori	AKMC	Përafrim	Ligj i ri	■	Harmonizim mesatar
31	Km rrugë	Infrastruktura	Nisje	Korridor Blu avancuar	■	Vonesa & akuza korrupsioni (Balluku)
32	Linja hekurudhore	Hekurudha	Avancim	EMU operacional	■	Progres i kufizuar
33	Ujë 24h urbane	UK	Operator	Në vijim	■	Zgjerim ngadalshëm
34	MË rinovues	Energjia	Plan	95% + Tropojë	■	Lider, por sfidë
35	Ekonomi qarkulluese	Mjedisi	Nisje	Progres	■	Vonesa operator
36	Eksporte bujqësore	INSTAT	+9%+	+9.1%	■	Progres mesatar
37	Ujitje ha	Bujqësia	Investime	Nisur	■	Avancim i kufizuar
38	Turistë	INSTAT	Rekord	11.7 mln (+6.6%)	■	Rekord absolut
39	Transaksione digjitale	BSH	Program	Nisur	■	Cashless fillestar

ID	KPI	Burimi	100-ditori	Realizimi	Status	Koment analitik
40	Papunësi	INSTAT	Ulje	8.1%		Tendencë mesatare
41	Pagë mesatare	INSTAT	+11%+	+11.6%		Rritje reale
42	% profesional	Arsimi	Zgjerim	Dual		Progres mesatar
43	Marrëveshje bilaterale	MPJ	Zgjerim	Në proces		Aktive
44	Hendek pagash	INSTAT	Miratim	Ligj barazi		Arritur
45	Aksidente pune	ISHPSH	Monitorim	Stabil		Kontroll mesatar
46	Shkolla të reja	Arsimi	Investime	Nisur		Ritëm mesatar
47	Konvikte profesional	Arsimi	Plan	Avancuar		Progres
48	Kampuse universitare	MAS	Investime	Nisur		Zhvillim mesatar
49	Model dual	Arsimi	Partneritet	Sukses		Lidhje treg
50	Lab inteligjentë	Arsimi	+650	Realizuar		Arritje madhe
51	Pagë mësues	MF	Graduale	Në buxhet		Rritje plan
52	Transport falas	Arsimi	Pilot	Zgjeruar		Akses mesatar
53	% PBB shëndetësi	MF	Rritje	Autonomi		Financim mesatar
54	Pritje & akses	Shëndetësia	Vazhdueshëm	Kontroll bazë		Cilësi mesatare
55	Pagë mjekë	MF	Fillestar	+35€+		Motivim mesatar
56	Dosje elektronike	e-Health	Pilot	Avancuar		Digjitalizim
57	Lista barna	MF	Zgjerim	Universal		Akses mesatar
58	Vaksinim & parandalim	ISHP	Harmonizim	Mekanizma		Progres mesatar
59	Përfitues sociale	MSSS	Zgjeruar	+10%+		Mbështetje mesatare
60	Pension mesatar	ISSH	Gradual	Bonus		Rritje mesatare
61	Paketë familje	MSSS	Diskutim	Subvencione		Në proces
62	Njësi strehimi	Zhvillimi Urban	Nisur	+200		Avancim mesatar
63	Varfëri	INSTAT	Stabil	Mbështetje		Ulje mesatare
64	Pagesa PAK	MSSS	Zgjeruar	Dyfishim		Progres
65	Garanci Rinore	Punësimi	Aktiv	40k+		Sukses

2.1. SQARIME PËR SECILIN OBJEKTIV

I. INTEGRIMI EUROPIAN & QEVERISJA (1–10)

1. Progresi i kapitujve të negociatave

Hapja e të gjashtë cluster-eve brenda vitit 2025 përfaqëson një rekord historik për Shqipërinë dhe sinjal politik pozitiv nga BE. Megjithatë, ky progres mbetet kryesisht procedural dhe ende jo i reflektuar në zbatim real të standardeve në terren.

2. Harmonizimi ligjor me *acquis*

Draftet ligjore për Cluster 5 janë përgatitur, por ritmi i miratimit është ngadalësuar nga axhenda e ngarkuar parlamentare dhe mungesa e konsultimeve të thelluara publike. Ekziston rreziku i “harmonizimit formal”, pa zbatim efektiv.

3. Kapaciteti negociues institucional

Struktura negociuese është funksionale dhe ka përfituar nga programe trajnimi me mbështetje të BE-së. Megjithatë, mbingarkesa e ekspertëve dhe rotacioni administrativ kufizojnë akumulimin e ekspertizës afatgjatë.

4. Transparenca e procesit të integrit

Publikimi i raporteve mujore rrit formalitetin e transparencës, por kritikën për informim selektiv dhe mungesë debati publik real mbeten të forta, veçanërisht për kapitujt ekonomikë dhe antikorrupsion.

5. Përafrimi i politikave sektoriale

Energjia dhe drejtësia shënojnë progres mbi mesataren, ndërsa bujqësia dhe mjedisi mbeten pas për shkak të fragmentimit institucional dhe financimit të pamjaftueshëm.

6. Koordinimi ndër-institucional BE

Takimet periodike të Këshillit të Ministrave sigurojnë koordinim formal, por mungon një mekanizëm i fortë llogaridhënieje për vonesat ndërsektoriale.

7. Digjitalizimi i shërbimeve publike

Me mbi 95% të shërbimeve online dhe lansimin e platformës “Diella”, Shqipëria ka arritur një shkallë të lartë digjitalizimi. Megjithatë, problemet teknike dhe akuzat për korrupsion në AKSHI e minojnë besimin publik.

8. Përdorimi real i platformave

Numri i përdoruesve është rritur, por ankesat për navigim, akses për grupet vulnerabël dhe ndërprerje shërbimesh tregojnë hendek mes dizajnit dhe përdorimit real.

9. Siguria kibernetike

Miratimi i Strategjisë Kombëtare 2025–2030 është një hap i rëndësishëm, por implementimi është ende në fazë fillestare dhe varet nga kapacitetet njerëzore dhe buxhetore.

10. Ndërveprueshmëria e databazave

Projektet GovTech kanë sjellë përmirësime, por mungesa e standardeve unike dhe rezistenca institucionale pengojnë ndërveprueshmërinë e plotë.

II. ADMINISTRATA, DREJTËSIA & SIGURIA (11–20)

11. Reforma e burimeve njerëzore

Portali i rekrutimit funksionon plotësisht, duke rritur transparencën formale. Megjithatë, ndikimi në meritokraci mbetet mesatar për shkak të ndërhyrjeve politike informale.

12. Depolitizimi i administratës

Monitorimi i OECD tregon stabilitet institucional, por jo përparim substancial drejt neutralitetit profesional.

13. Sistemet e integritetit & antikorrupsionit

SPAK ka rritur intensitetin e veprimeve nën drejtimin e ri, por skandalet e fundit (AKSHI, tendera infrastrukture) kanë ulur ndjeshëm besimin publik.

14. Efikasiteti i sistemit të drejtësisë

ICMJ është operacional, por stoket e çështjeve dhe vonesat procedurale mbeten sfidë strukturore.

15. Zbatimi i reformës në drejtësi

Përfundimi i vettingut shënon konsolidim institucional, por cilësia e vendimmarrjes gjyqësore mbetet e pabarabartë.

16. Siguria publike

Kontrata Smart City është shtrirë në 20 qytete, por efektet në uljen e kriminalitetit janë ende të kufizuara.

17. Menaxhimi i emergjencave

Zgjerimi i qendrave të emergjencave është në proces, por koordinimi ndërinstitucional mbetet i dobët.

18. Politika e jashtme & diaspora

Rritja e IHD-ve (~1.7 mld €) lidhet pjesërisht me diasporën, por ndikohet edhe nga klima politike e brendshme.

19. Stabiliteti fiskal

Deficiti 2.3% është brenda planifikimit afatmesëm dhe sinjalizon disiplinë fiskale të qëndrueshme.

20. Borxhi publik

Ulja graduale në 55–56% është pozitive, por ritmi mbetet i ngadalshëm përballë nevojave investuese.

III. EKONOMIA, BIZNESI & INFRASTRUKTURA (21–40)

21. Cilësia e shpenzimeve publike

Buxhetimi me performancë është aplikuar, por prioritetet mbeten të fragmentuara dhe të politizuara.

22. Administrimi tatimor

Digjitalizimi ka rritur mbledhjen, por lufta ndaj evazionit mbetet mesatare dhe selektive.

23. Formalizimi i ekonomisë

Masat ekzistuese nuk kanë sjellë ulje drastike të informalitetit, veçanërisht në shërbime dhe bujqësi.

24. Parashikueshmëria fiskale

Diskutimi për “Paqen Fiskale” krijon pasiguri dhe ka ngritur shqetësime nga FMN për moral hazard.

25. Klima e biznesit

Liberalizimi rregullator ka përmirësuar procedurat, por pasiguria ligjore mbetet.

26. Barrat administrative

Lehtësimi është i pjesshëm dhe i pabarabartë mes sektorëve.

27. Investimet e huaja

Rekordi i IHD-ve në 2025 mbështetet kryesisht nga energjia dhe turizmi.

28. Ndërmarrjet e vogla & inovacioni

Eventet dhe grantet janë rritur, por ndikimi në produktivitet është ende modest.

29. PPP & risku fiskal

Monitorimi është përmirësuar, por ekspozimi fiskal mbetet i lartë.

30. Konkurrenca & tregjet

Përafrimi me BE është mesatar, me probleme në zbatim.

31. Infrastruktura rrugore

Korridori Blu ka nisur, por vonesat dhe akuzat për korrupsion rrisin riskun fiskal.

32. Transporti publik

EMU është operacional, por mbulimi dhe cilësia janë të kufizuara.

33. Uji & mbetjet

Reformat janë në proces, por avancimi është i ngadaltë.

34. Energjia & diversifikimi

95% prodhim rinovues është arritje e fortë, me plane shtesë (Tropojë).

35. Tranzicioni i gjelbër

Progresi është i vonuar nga problemet me operatorët e mbetjeve.

36. Bujqësia & zinxhiri i vlerës

Rritja e eksporteve (+9.1%) tregon potencial, por vlera e shtuar mbetet e ulët.

37. Zhvillimi rural

Investimet kanë nisur, por fragmentimi institucional pengon efektin.

38. Turizmi i qëndrueshëm

11.7 milion turistë përfaqësojnë rekord historik, por presioni mjedisor po rritet.

39. Dixhitalizimi ekonomik

Programi Cashless është nisur, por përdorimi mbetet selektiv.

40. Punësimi

Papunësia 8.1% tregon stabilitet, por jo transformim strukturor.

IV. KAPITALI NJERËZOR & MIRËQENIA (41–65)

41. Pagat & produktiviteti

Rritja 11.6% e pagave ka qenë reale, por jo plotësisht e mbështetur nga produktiviteti.

42. Formimi profesional

Zgjerimi i modelit dual ka sjellë rezultate mesatare.

43. Migracioni ekonomik

Marrëveshjet janë në proces, por efekti ende i kufizuar.

44. Barazia gjinore në punë

Ligji i ri krijon bazë ligjore, por zbatimi mbetet sfidë.

45. Siguria në punë

Monitorimi është stabil, pa përmirësime të mëdha.

46. Arsimi parauniversitar

Investimet janë rritur, por ritmi mbetet mesatar.

47. Arsimi profesional

Planet për konvikte tregojnë orientim praktik.

48. Arsimi i lartë

Investimet në kampuse janë në fazë fillestare.

49. Lidhja arsim-treg pune

Modeli dual po funksionon me sukses të moderuar.

50. Digjitalizimi i arsimit

650 laboratorë digjitalë përfaqësojnë një nga arritjet më të forta.

51. Cilësia e mësimdhënies

Rritja buxhetore është graduale, pa reformë strukturore.

52. Barazia në akses arsimor

Pilot-projektet e transportit kanë efekt pozitiv lokal.

53. Financimi i shëndetësisë

Autonomia financiare është rritur, por burimet janë të kufizuara.

54. Akses & cilësi shërbimi shëndetësor

Kontrollet bazë janë të qëndrueshme.

55. Burimet njerëzore shëndetësore

Rritja prej +35 € për mjekët fillestarë ka efekt simbolik.

56. Digjitalizimi shëndetësor

Pilotimi i dosjes elektronike është në fazë avancimi.

57. Barnat & furnizimi

Aksesi është zgjeruar, por zinxhiri i furnizimit mbetet problematik.

58. Parandalimi & shëndeti publik

Harmonizimi me BE është mesatar.

59. Skemat e mbrojtjes sociale

Zgjerimi mbi 10% ka stabilizuar grupet vulnerabël.

60. Pensionet

Bonusi gradual përmirëson të ardhurat, por jo qëndrueshmërinë.

61. Mbështetja familjare

Subvencionet janë ende në diskutim.

62. Strehimi social

200 njësi të reja janë nisur, me ndikim të kufizuar.

63. Varfëria & përjashtimi social

Situata mbetet stabile, pa ulje strukturore.

64. Personat me aftësi ndryshe

Dyfishimi i pagesave ka rritur mbrojtjen sociale.

65. Politikat për të rinjtë

Garancia për mbi 40 mijë të rinj është aktive, me efekt të matshëm në punësim.

3. VLERËSIMI I FIZIBILITETIT TË PROGRAMIT QEVERISËS 2025–2029 (IFP)

IFP (Index of Feasibility & Performance) mat jo ambicien, por **zbatueshmërinë reale** të objektivave në 100 ditë, sipas katër dimensioneve të barabarta:

- **Fiskal (0–25)** – A ka burime reale buxhetore pa rrezikuar stabilitetin?
- **Institucional (0–25)** – A ekzistojnë kapacitete, struktura dhe autoritet?
- **Kohor (0–25)** – A është e realizueshme brenda 100 ditëve?
- **Koherencë (0–25)** – A është e lidhur me politikat ekzistuese dhe BE?

Vlerat mbi **70** tregojnë fizibilitet të mirë,

Vlerat midis **60–70** tregojnë fizibilitet të kushtëzuar,

Vlerat nën **65** tregojnë rrezik operacional.

ID	Fiskal (0–25)	Institucional (0–25)	Kohor (0–25)	Koherencë (0–25)	TOTAL (0–100)
1–6 (Integrimi)	23	22	21	23	89
7–13 (Digjital & Admin)	17	16	15	17	65
14–18 (Drejtësi & Siguri)	18	18	17	18	71
Shtylla I					75
19–24 (Fiskale)	21	17	17	18	73
25–30 (Biznes)	18	19	17	18	72
31–39 (Infrastruktura)	16	17	15	16	64
40–45 (Punë)	20	18	18	19	75
Shtylla II					71
46–52 (Arsim)	17	17	16	17	67
53–58 (Shëndetësi)	19	17	16	17	69
59–65 (Sociale)	18	19	17	18	72
Shtylla III					69
TOTAL PROGRAMI					72

IFP SIPAS SHTYLLAVE

Shtylla	IFP Mesatar	Ndryshim nga fillimi
I	75	+8 (BE rekord, por korrupsion ul)
II	71	+4 (turizëm, por infrastrukturë rrezik)
III	69	+2 (pagë, por sfida zbatim)
TOTAL	72	+4 (fizibilitet mesatar)

3.1. VLERËSIMI ANALITIK I PROGRAMIT QEVERISËS

Leximi i rezultateve përtej shifrave

SHTYLLA I – SHTETI, INTEGRIMI, QEVERISJA

Vlerësim final - 75 / 100

Kjo shtyllë paraqitet si më e forta në aspektin politik dhe strategjik, por jo e njëtrajtshme në realizim teknik. Rezultati relativisht i lartë reflekton faktin që integrimi europian vepron si një “forcë tërheqëse” e vazhdueshme, që strukturon vendimarrjen, orienton ligjvënien dhe ushtron presion pozitiv mbi administratën.

Megjithatë, brenda së njëjtës shtyllë bashkëjetojnë dy dinamika të ndryshme, ku:

- **Integrimi europian** rrit mesataren e fizibilitetit, sepse mbështetet në një proces të institucionalizuar, me afate, mekanizma monitorimi dhe presion të jashtëm të vazhdueshëm. Edhe kur progresi është i ngadalshëm, ai është i matshëm dhe i krahasueshëm.
- **Digjitalizimi i shtetit**, përkundrazi, e ul rezultatin relativ, jo për mungesë ambicieje, por për shkak të hendekut mes zgjidhjeve teknologjike dhe kapaciteteve reale institucionale. Problemi nuk është “teknologjia”, por mungesa e integritetit administrativ, ndërveprueshmërisë dhe përdorimit real nga qytetarët.

Në këtë kuptim, Shtylla I është politikisht koherente dhe strategjikisht e orientuar drejt BE-së, por teknikisht e pabarabartë në zbatim. Ajo prodhon progres procedural më shumë sesa transformim funksional të menjëhershëm.

SHTYLLA II – EKONOMIA, FISKALITETI, INFRASTRUKTURA

Vlerësim mesatar - 71 / 100

(i mirë, por me rrezik fiskal latent)

Kjo shtyllë përfaqëson “boshtin e rëndësës” së programit, pasi lidh rritjen ekonomike, financat publike dhe investimet. Rezultati prej 71 tregon një ekonomi funksionale dhe relativisht të qëndrueshme, por me tensione të brendshme që nuk janë gjithmonë të dukshme në afat të shkurtër.

Politikat fiskale (objektivat 19–24) – Vlerësim: 73

Politika fiskale shfaq disiplinë dhe vazhdimësi. Korniza buxhetore është e njohur, instrumentet ekzistojnë dhe administrimi fiskal është relativisht i konsoliduar. Problemi kryesor nuk është

struktural, por **politik**: rreziku vjen nga iniciativa ad-hoc, si paketat fiskale të shpallura jashtë ciklit normal të planifikimit.

Kjo do të thotë se fizibiliteti është i mirë në kushte normaliteti, por shumë i ndjeshëm ndaj vendimeve të paplanifikuara, që mund të minojnë parashikueshmërinë dhe besueshmërinë fiskale.

Biznesi dhe tregjet (25–30) – Vlerësim: 72

Klima ligjore dhe rregullatore është përgjithësisht e qëndrueshme. Reformat e propozuara janë kryesisht procedurale dhe synojnë përmirësim gradual të funksionimit, jo ndryshim të modelit ekonomik.

Kjo i bën politikat relativisht të zbatueshme dhe me risk të ulët dështimi, por pa efekt transformues afatshkurtër. Programi këtu garanton stabilitet, jo domosdoshmërisht një kërcim cilësor në produktivitet.

Infrastruktura (31–39) – Vlerësim: 64

Kjo është zona më problematike e gjithë programit. Vlerësimi i ulët reflekton një kombinim rreziqesh:

- **Fiskale**, ku projektet kanë kosto të larta kapitale dhe ndikim afatgjatë në borxh.
- **Kohore**, ku infrastruktura nuk prodhon rezultate në 100 ditë dhe vonesat janë strukturore.
- **Koherencë**, pasi përdorimi i gjerë i PPP-ve rrit riskun fiskal latent dhe ekspozimin reputacional.

Kjo e bën infrastrukturën jo vetëm sfidë teknike, por edhe rrezik politik, për shkak të perceptimeve për korrupsion, vonesave kronike dhe transparencës së kufizuar. Është segmenti me probabilitetin më të lartë për devijim nga programi fillestar.

Punësimi dhe tregu i punës (40–45) – Vlerësim: 75

Ky segment është ndër më të balancuarit. Politikat janë kryesisht vazhdimësi e instrumenteve ekzistuese, pa eksperimente të rrezikshme. Treguesit janë të matshëm dhe relativisht të qëndrueshëm, çka rrit besueshmërinë e zbatimit.

Rezultati i lartë reflekton faktin që kjo fushë është më pak e ekspozuar ndaj riskut fiskal dhe më e lidhur me dinamika reale të tregut.

Kjo shtyllë e programit është ekonomikisht e qëndrueshme, por me një pikë të dobët strukturore të qartë: infrastruktura. Pa adresimin e saj, kjo shtyllë mbetet funksionale, por jo transformuese.

SHTYLLA III – KAPITALI NJERËZOR & MBROJTJA SOCIALE

Vlerësim mesatar - 69 / 100

Kjo shtyllë është socialisht e domosdoshme, por me potencial reformues të ngadaltë, sidomos në horizontin 6-mujor ose 100-ditor.

Arsimi (46–52) – Vlerësim: 67

Ka investime të dukshme fizike dhe teknologjike, por reformat strukturore në arsim kërkojnë kohë për të dhënë rezultate. Hendeku mes investimit dhe cilësisë mbetet sfidë.

Shëndetësia (53–58) – Vlerësim: 69

Digjitalizimi është në fazë pilote dhe kapacitetet njerëzore janë nën presion. Sistemi funksionon, por me ngarkesë dhe pa rezerva të mjaftueshme.

Politikat sociale (59–65) – Vlerësim: 72

Skemat ekzistuese zgjerohen relativisht lehtë dhe kanë efekt stabilizues. Megjithatë, ato nuk transformojnë strukturën sociale, por menaxhojnë pasojat e saj.

VLERËSIMI TOTAL I PROGRAMIT - 72 / 100

Programi 2025–2029 është një program **menaxhimi dhe stabiliteti**, jo një program transformimi të shpejtë.

Forca e tij qëndron te koherenca dhe kontrolli i rrezikut, ndërsa dobësia, te mungesa e guximit për reforma strukturore me kosto afatshkurtër.

Në këtë kuptim, **monitorimi 6-mujor dhe Indeksi i Fizibilitetit** nuk janë thjesht instrumente analitike, por mekanizma kritikë për të kuptuar nëse stabiliteti po kthehet në progres real, apo thjesht në mirëmbajtje të status quo-së.

4. ALARMET E RREZIKUT

Matrica e **Alarmeve të Rrezikut** nuk është një shtesë formale e vlerësimit, por mekanizmi kritik që lidh analizën numerike me **vendimmarrjen reale politike dhe administrative**. Ajo tregon qartë se ku programi kalon nga “i realizueshëm në letër” në **i rrezikuar në zbatim**, dhe çfarë duhet bërë për të mos humbur kontrollin institucional.

Në këtë kuadër, alarmet e identifikuar paraqesojnë **pika të nxehta sistemike**, jo incidente të izoluara.

ID	Objektivi	Status	Arsye rreziku	Veprim i rekomanduar
7–8	Digjitalizimi		Skandal AKSHI (8 akuzuar për tendera, grup kriminal)	Audit urgjent & reformë
13	Antikorrupsioni		Akuza të reja AKSHI & Balluku (abuzim tendera)	Hetime të plota SPAK
31–33	Infrastruktura		Akuza Balluku (50 mln € humbje tendera)	Transparencë PPP & IPA
23–24	Fiskale		Rrezik Paqe Fiskale (FMN)	Monitorim evazion
35	Tranzicioni gjelbër		Vonesë operator mbetje	Ligj i ri & fonde Green Deal

Digjitalizimi (Objektivat 7–8) – Alarm i kuq sistematik

Digjitalizimi, megjithëse konceptualisht shtyllë modernizuese, shndërrohet në **burim rreziku të lartë reputacional dhe operacional** për shkak të skandalit AKSHI, ku akuzat për tendera dhe përfshirje kriminale minojnë vetë themelet e besueshmërisë së reformës. Në këtë rast, problemi nuk është teknologjia, por **kapja institucionale e proceseve digjitale**.

Rreziku është digjitalizimi formal, pa integritet.

Veprim i domosdoshëm është auditimi urgjent, rikonceptimi i arkitekturës së prokurimit dhe ndarja e qartë mes funksionit teknik dhe atij politik

Nëse nuk kryhet nëkohë reale kjo ndërhyrje, atëherë çdo progres i raportuar do të jetë i kontestueshëm dhe i pambrojtshëm publikisht.

Antikorrupsioni (Objektivi 13) – Alarm i kuq politik

Akuzat e reja që lidhen me AKSHI dhe Balluku e vendosin këtë objektivi në **kontradiktë të drejtpërdrejtë me narrativën e qeverisjes së mirë**. Këtu rreziku nuk është vetëm ligjor, por **strategjik**: humbje e koherencës mes fjalës dhe veprimit.

Rreziku është delegjitimimi i gjithë paketës antikorrupsion.

Veprim i domosdoshëm është hetimi i plotë nga SPAK dhe insitucionet e auditimit në funksion të hetimit, pa ndërhyrje politike

Nëse ky alarm neglizhohet, efekti domino shtrihet në integrim, financa publike dhe besimin qytetar.

Infrastruktura (Objektivat 31–33) – Alarm i kuq fiskal dhe reputacional

Akuza për humbje rreth 50 milionë euro nga tendera infrastrukture e konfirmojnë vlerësimin e mëparshëm: kjo është **zona më problematike e programit**. PPP-të, vonesat dhe mungesa e transparencës krijojnë një **minë fiskale me ndezje të vonuar**.

Rreziku është rritja e detyrimeve të fshehura dhe ekspozim ndaj skandaleve.

Veprim i domosdoshëm është transparenca e plotë e PPP-ve, auditimi i projekteve dhe lidhja e fondeve IPA me performancën reale

Nëse nuk bëhet kjo kthesë, atëherë infrastruktura mbetet pika që “e fundos” mesataren e gjithë programit.

Politika Fiskale (Objektivat 23–24) – Alarm i verdhë preventiv

Ndryshe nga alarmet e kuqe, këtu kemi një **rrezik potencial**, jo të materializuar plotësisht. Paralajmërimet e FMN-së për “Paqen Fiskale” sinjalizojnë devijim nga disiplina ekzistuese dhe hapje të shtigjeve për evazion të amnistuar.

Rreziku është prishja e “kontratës” së besueshmërisë fiskale

Veprim i domosdoshëm është monitorimi i fortë i evazionit dhe kufizimi strikt i masave ad-hoc

Ky alarm kërkon vigjilencë, jo panik, por toleranca zero ndaj improvizimit politik.

Tranzicioni i Gjelbër (Objektivi 35) – Alarm i kuq operacional

Vonesat në menaxhimin e mbetjeve tregojnë se tranzicioni i gjelbër mbetet **retorikë pa kapacitet zbatues**. Pa operator funksional dhe pa kornizë ligjore të qartë, fondet e Green Deal rrezikojnë të mbeten të pashfrytëzuara.

Rreziku është humbja e fondeve dhe diskreditimi ndërkombëtar.

Veprim i domosdoshëm është një ligj i ri funksional dhe mobilizim i fondeve të dedikuara

Këto alarme tregojnë se problemi kryesor i programit nuk është mungesa e objektivave, por **mungesa e kontrollit të rrezikut në zbatim**.

Nëse nuk adresohen, ato e ulin ndjeshëm **Indeksin e Fizibilitetit** në monitorimin 6-mujor dhe rrezikojnë ta zhvendosin programin nga “i realizueshëm” në “i menaxhuar me kriza”.

Programi mund të ecë përpara vetëm nëse alarmet trajtohen si **udhërrëfyes veprimi**, jo si kosto politike për t’u shmangur.

4.1. MATRICA “TRAFFIC LIGHT”

Kjo matricë **nuk mat progresin**, por **rrezikun sistematik** që mund të:

- bllokojë objektivat operacionale,
- dëmtojë besueshmërinë institucionale,
- krijojë kosto fiskale ose reputacionale afatmesme,
- përkthehet në regres politik ose penal.

Ngjyrat sinjalizojnë **nivelin e urgjencës, ku:**

 e **KUQJA** tregon rrezik kritik, kërkon ndërhyrje të menjëhershme

 e **VERDHA** tregon rrezik potencial, kërkon monitorim aktiv

 **JESHILJA** tregon se nuk ka rrezik domethënës.

Objektivi kryesor	Status	Koment i shkurtër
Integrimi EU		Rekord historik: të gjitha kapitujt hapur, progres i fortë drejt 2027
Digjitalizim		Avancim fillestar (Diella, 95% shërbime), por probleme funksionimi dhe akuza korrupsioni në AKSHI
Fiskal & Borxh		Deficit në linjë (2.3%), borxh stabil, por rrezik nga Paqja Fiskale dhe informaliteti
Turizëm & Punësim		Rekord absolut turistësh (11.7 mln) dhe ulje papunësie, pagë mesatare +11.6%
Infrastruktura		Nisje projektesh (Porto Romano, Korridor Blu), por vonesa të mëdha dhe akuza serioze korrupsioni (tendera, Balluku)
Arsim & Shëndetësi		Progres në laboratorë SMART dhe rritje pagash, por sfida në cilësi (PISA, pritje spitalore) dhe zbatim afatgjatë

MATRICA “TRAFFIC LIGHT” tregon se:

Rreziqet **nuk janë të shpërndara rastësisht**, por të përqendruara në:

- digjitalizim,
- infrastrukturë,
- antikorrupsion,
- mjedis.

Shumica e alarmeve janë **institucionale dhe etike**, jo teknike.

Nëse nuk adresohen, këto rreziqe mund të **neutralizojnë progresin formal** të raportuar në fusha të tjera (integrim BE, stabilitet fiskal).

Progresi pa integritet prodhon regres.

Pa menaxhim rreziku, monitorimi kthehet në raportim formal.

5. NDËRLIDHJA E ALARMEVE TË RREZIKUT

me IFP dhe Objektivat e Integritetit European

Ndërlidhja mes **alarmeve të rrezikut**, Indeksit të Fizibilitetit të Programit (IFP) dhe **objektivave të integritetit european** përbën boshtin real ku matet jo vetëm realizueshmëria teknike e programit, por edhe **kredibiliteti politik i shtetit në procesin e negociatave me Bashkimin European**.

Kjo ndërlidhje nuk është teorike dhe as abstrakte. Ajo vepron drejtpërdrejt mbi mënyrën se si progresi lexohet, vlerësohet dhe kushtëzohet nga institucionet europiane.

Në thelb, alarmet e rrezikut nuk janë episode të veçuara apo kriza komunikimi.

Ato janë **shkaktarë strukturorë që gjëryejnë komponentët bazë të IFP-së**, funksionimin institucional, qëndrueshmërinë fiskale, respektimin e afateve dhe koherencën e politikave.

Sa herë që një alarm aktivizohet dhe mbetet pa adresim, ai e ul realisht indeksin e fizibilitetit dhe, në të njëjtën kohë, prek drejtpërdrejt kapituj kyç të *acquis communautaire*.

Kjo krijon një zinxhir të qartë: **alarm i pamenaxhuar → rënie e IFP-së → dobësim i objektivave të BE-së → humbje e besueshmërisë negociuese**.

Rasti i digjitalizimit dhe skandalit të AKSHI-t e ilustron më qartë këtë logjikë. Digjitalizimi, i menduar si instrument modernizimi institucional, shndërrohet në faktor rreziku kur shoqërohet me akuza për abuzim dhe kapje të proceseve të prokurimit.

Në këtë situatë, dëmtohet jo vetëm komponenti institucional i IFP-së, por edhe koherenca dhe dimensionin kohor i reformës. Nga këndvështrimi european, kjo nuk lexohet si vonesë teknike, por si **mungesë integriteti qeverisës**.

Për pasojë, preken drejtpërdrejt kapitujt e Cluster 1, veçanërisht Kapitujt 23 dhe 24, si edhe Kapitulli 10 mbi shoqërinë digjitale. Mesazhi që BE merr është i qartë: digjitalizimi pa garanci institucionale nuk ul riskun, por e centralizon atë.

Një logjikë e ngjashme vepron edhe në fushën e antikorrupsionit. Kur akuzat përfshijnë institucione kyçe dhe projekte madhore, rreziku bëhet transversal dhe prek gjithë programin. Në këtë rast, nuk është vetëm një objektivi që vihet në dyshim, por **koherenca e të gjithë narrativës reformuese**.

Për BE-në, progresi formal në ligje dhe struktura humbet vlerë nëse korrupsioni perceptohet si sistematik.

Kjo ndikon drejtpërdrejt mbi Kapitujt 23 dhe 24 dhe mbi kushtëzimin themelor të sundimit të ligjit, duke e kthyer antikorrupsionin nga avantazh deklarativ në pikë presioni negociues.

Infrastruktura dhe përdorimi i PPP-ve përbëjnë një tjetër nyje kritike të ndërlidhjes mes IFP-së dhe integritetit european. Këtu rreziku shfaqet në mënyrë të shumëfishtë: fiskal, kohor dhe koherent.

Projektet e kushtueshme, vonesat e zgjatura dhe mungesa e transparencës krijojnë perceptimin e borxhit të fshehur dhe të shtrembërimit të konkurrencës. Nga perspektiva e BE-së, kjo cenon drejtpërdrejt kapitujt e prokurimit publik, konkurrencës, politikës rajonale dhe kontrollit financiar. Infrastruktura, në vend që të shihet si motor zhvillimi, lexohet si **burim rreziku për qëndrueshmërinë fiskale dhe institucionale**.

Edhe politika fiskale, megjithëse aktualisht në zonë më pak kritike, mbart një alarm preventiv me peshë të madhe. Iniciativa si “Paqja Fiskale” interpretohen nga FMN dhe Komisioni Europian jo si fleksibilitet, por si sinjal dobësie shtetërore dhe regres institucional.

Kjo **ndikon mbi kapitujt e tatimeve, politikës ekonomike dhe kontrollit financiar**, duke ulur koherencën e politikave dhe duke rrezikuar disiplinën fiskale të ndërtuar ndër vite.

Tranzicioni i gjelbër dhe menaxhimi i mbetjeve përmbyllin panoramën e ndërlidhjes së rrezikut. Pa kapacitet operativ dhe kornizë funksionale ligjore, tranzicioni mbetet retorik.

Vonesat në këtë fushë lexohen nga BE si mungesë kapaciteti shtetëror dhe cenojnë drejtpërdrejt Kapitullin 27, Green Deal-in dhe Agjendën e Gjelbër të Cluster 4. Në këtë rast, rreziku nuk është vetëm humbja e fondeve, por **diskreditimi i angazhimit afatgjatë**.

Në mënyrë të përmbledhur, kjo ndërlidhje tregon se pikat ku IFP bie realisht nuk janë financiare në radhë të parë, por institucionale. Bashkimi Europian nuk penalizon mungesën e shpejtësisë apo ritmin e reformave, por penalizon mungesën e integritetit, koherencës dhe kapacitetit shtetëror për të menaxhuar rrezikun.

Nëse alarmet e kuqe mbeten të paadresuara, IFP-ja reale rrëshqet nga 72 në rreth 66–67, progresi europian mbetet procedural dhe vendi rrezikon të kalojë nga pozicioni i “liderit rajonal” në një **rast nën vëzhgim të shtuar**.

Nëse, përkundrazi, këto alarme adresohen në një horizont 3–6 mujor, indeksi stabilizohet mbi 75, kapitujt më të ndjeshëm fitojnë besueshmëri dhe progresi formal fillon të përkthehet në **progres real negociues**.

ÇFARË TREGON REALISHT KJO ANALIZË PËR QEVERISJEN NË 2026 DHE INTEGRIMIN?

Nëse kjo analizë do të përkthehet në një mesazh të qartë për publikun, tendenca e qeverisjes 2025–2029 mund të përmblihet kështu:

- Ne kemi një qeverisje që di të ruajë stabilitetin dhe të menaxhojë proceset, por që ende nuk ka hyrë vendosmërisht në fazën e reformave të thella strukturore.

Rezultati total i IFP-së, **72/100**, nuk flet për krizë dhe as për dështim.

Ai tregon një program **të realizueshëm**, të ndërtuar mbi vazhdimësi, kontroll dhe disiplinë, por jo një program që prodhon ndryshime të shpejta në strukturën e shtetit, ekonomisë apo shërbimeve publike.

Me fjalë të thjeshta, **qeverisja funksionon, por nuk po transformon ende.**

Nga pikëpamja e **integritit europian**, tendenca është dukshëm pozitive në aspekt procedural dhe formal.

Hapja e të gjithë kapitujve, progresi në Cluster 1 dhe presioni konstant i BE-së e kanë rritur ndjeshëm fizibilitetin e shtyllës së integritit. Kjo e bën Shqipërinë të duket e qëndrueshme dhe serioze në tryezën negociuese.

Megjithatë, analiza tregon qartë se **BE-ja po sheh gjithnjë e më pak vetëm ligjet dhe raportet, dhe gjithnjë e më shumë integritetin e zbatimit**. Pikërisht këtu shfaqen kufijtë e modelit aktual të qeverisjes.

Alarmet e rrezikut zbulojnë një problem thelbësor, se rreziqet nuk janë të shpërndara rastësisht, por të përqendruara në disa fusha kyçe, si digjitalizim, infrastrukturë, antikorrupsion dhe mjedis.

Këto nuk janë probleme teknike, por **probleme institucionale dhe etike**.

Kjo do të thotë se pengesa kryesore për reformën nuk është mungesa e fondeve apo e planeve, por **mungesa e kapacitetit për të kontrolluar rrezikun dhe për të garantuar integritetin**.

Në këtë kontekst, **buxheti 2026** dhe programet e lidhura me të japin një sinjal të përzier.

Nga njëra anë, buxheti konfirmon vazhdimësinë fiskale, stabilitetin makroekonomik dhe mbështetjen për sektorë si punësimi, pagat dhe politikat sociale. Kjo është pozitive dhe e nevojshme.

Nga ana tjetër, buxheti **nuk sinjalizon ende një zhvendosje të fortë drejt reformave strukturore me kosto afatshkurtër**, sidomos në administratë, infrastrukturë dhe luftën reale kundër korrupsionit.

Pra, ai mbështet menaxhimin e status quo-së më shumë sesa thyerjen e saj.

Pyetja kryesore për publikun është, se **a vlerësohet kjo tendencë shpresëdhënëse?**

Përgjigjja e POLIFAKT është e balancuar në:

- **Po**, është shpresëdhënëse në kuptimin që **nuk ka destabilizim**, nuk ka devijim fiskal të pakontrolluar dhe procesi i integritetit evropian ecën përpara.
- Por **jo mjaftueshëm** shpresëdhënëse nëse pritet **transformim strukturor**, ulje e ndjeshme e korrupsionit, rritje e besimit institucional dhe përmirësim i shpejtë i cilësisë së shtetit.

Nëse alarmet e kuqe vazhdojnë të trajtohen si kosto politike për t'u menaxhuar dhe jo si sinjale për reformë reale, atëherë qeverisja rrezikon të mbetet në një **model administrimi të përhershëm**, ku progresi raportohet, por ndryshimi ndihet pak. Në këtë skenar, integrimi evropian mbetet procedural dhe IFP-ja ka tendencë të bjerë drejt zonës së rrezikut.

Nëse, përkundrazi, qeveria përdor buxhetin 2026 dhe ciklin e ardhshëm politik për të **ndërmarrë reforma institucionale reale**, për të pastruar pikat kritike të digjitalizimit, për të riformatuar mënyrën e investimeve infrastrukturore dhe për të lënë drejtësinë të veprave pa ndërhyrje, atëherë tendenca aktuale mund të kthehet në një **trajektore reale transformimi**. Vetëm në këtë rast stabiliteti do të shndërrohet në progres, dhe progresi procedural në **integrim real evropian**.

Programi dhe qeverisja në këto 100 ditë tregojnë se drejtimi i shpallur është i arritshëm, **por pika vendimtare është nëse qeveria do të kalojë nga menaxhimi i stabilitetit në reforma strukturore reale**.

Në të kundërt, nëse alarmet kritike vazhdojnë të mbeten të paadresuara, ekziston rreziku që programi të ngeçë në një cikël pritjeje dhe administrimi, duke riprodhuar përvojën e qeverisjes Rama 3, ku për katër vite (2021–2025) IFP-ja mbeti rreth 67% dhe ndryshimi strukturor nuk u realizua.

Tiranë, 27 Dhjetor 2025



POLIFAKT